

“RELATIVIZMI” I LIRISË SË PROFESIONEVE TË LIRA NË FUNKSION TË NJË SHËRBIMI “ABSOLUTISHT” NË TË MIRË TË QYTETARËVE DHE NË PËRPUTHJE ME LIGJIN: ZGJIDHJET ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE: NDËRMJETËSIMI DHE ARBITRAZHI

Prof. As. Dr. Arta MANDRO*

Abstrakt:

Ky punim trajton çështje që lidhen me përdorimin e procedurave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Pas trajtimit të mundësive ekzistuese të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) punimi evidenton aktorët kryesorë që ndikojnë në favor të ZAM në Shqipëri. Përveç sqarimit të asaj se çfarë mund të zgjidhet përmes ZAM nëpërmjet shqyrtimit të kuadrit ligjor, në fund të punimit trajtohen edhe sfidat drejt së ardhmes.

Fjalët kyç: *Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi, kuadri ligjor shqiptar.*

1. Hyrje

Ritmi i shpejtë i ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike në vendin tonë në këto dy dekadat e fundit, është karakterizuar përgjithësisht nga rritja e numrit të konflikteve të cilat përgjithësisht shohin ende si rrugën më të shkurtër për zgjidhjen e tyre atë drejt gjykatës. Prirjet e reja në sjelljet bashkëkohore të diktuar nga rrjedha impulsive e jetës në një ekonomi tregu ku duhet të bashkëjetojë publikja me privaten, por edhe “privatet” heterogjene me njëra tjetrën tregojnë se një numër i madh mosmarrëveshjesh janë të një natyre krejt të re, disa prej tyre të mbartura, e disa te sajuara, disa më të thjeshta e të tjera më të komplikuar.

* Pedagoge, Departamenti i së Drejtës Publike dhe Departamenti i së Drejtës Civile; Universiteti Jopublik “Justicia”, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, Shqipëri.

Ndërsa jepen një mori argumentesh në favor të përdorimit të ZAM dhe teknikave e rezultateve efektive të këtyre metodave, ndërsa aktet normative të fushave të ndryshme gjithnjë e më shumë nxisin përdorimin e procedurave të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, konstatohet lehtësisht se aktivitete të tilla për të zgjidhur informalisht mosmarrëveshjet, në realitetin shqiptar, janë të minimizuara. Qëllimi im këtu nuk është që të argumentoj që marrëveshja e arritur në këtë mënyrë të zëvendësojë në mënyrë të përsosur gjykimin, por që të nënvizoj se në këtë proces marrëveshja e arritur qaset ose arrin të njëjtin qëllim sikurse edhe gjykimi e si e tillë është një alternative e cila në disa rrethana e kushte ka avantazhe kundrejt rrugës gjyqësore. Synimi është që të stimulohen një varg i pafund shërbimesh të cilat pa dyshim janë më efektive se sa thjesht një ndërhyrje finale, siç është ajo gjyqësore, mundësia e së cilës është një rezervë në gatishmëri.

Nisur nga avantazhet e ZAM, nuk është për tu çuditur që shumë shtete, ndërmjet të cilëve edhe vendi ynë, pikërisht këto vite, kanë nisur intensivisht punën për reformimin e të drejtës së tyre pronësore, martesore dhe familjare, tregtare, penale, të punës, etj, duke i lënë shteg të lirë ligjërish edhe këtyre mundësive për zgjidhje të reja ligjore por jashtë gjyqësore. Edhe në Shqipëri, megjithë vështirësitë e sfidat, forcimi i shtetit të së drejtës, reforma ligjore, reforma në sistemin e drejtësisë si edhe lufta kundër e korrupsionit bënë të mundur që ti kushtohet një kujdes i veçantë ndërmjetësimit dhe alternativave të tjera të ZAM.

Përzgjedhja e alternativës pa dyshim varet nga lloji i konfliktit dhe rezultati i dëshiruar. Gjithsesi, pavarësisht ndryshimeve ndërmjet alternativave të ZAM, ato sigurojnë ose kontribuojnë në parandalimin e konfliktit, dhënien e ndihmës procedurale, lehtësim, pajtim, negociim, ndërmjetësim, ndihmë për vendim marrje, arbitrim.

2. Alternativat e ZAM

Në alternativat e ZAM bëjnë pjesë:

- Parandalimi: i cili përfshin dy aspekte, parandalimin e konfliktit në të ardhmen edhe parandalimin e përshkallëzimit e mëtejshëm të tij përmes sistemeve operative të cilat reagojnë me shpejtësi dhe efikasitet.
- Negocimi: procesi ku dy ose më shumë persona kërkojnë të arrijnë një marrëveshje përmes komunikimit. Si rrjedhojë palët mund të realizojnë përfitime të karakterit reciprok ose edhe individual.

- Lehtësimi i cili realizohet përmes një personi i cili ndonëse nuk ka një rol thelbësor në proces, përpiket që palët të realizojnë synimet e tyre. Lehtësuesit zakonisht ndihmojnë që të merret një vendim me konsensus
- Pajtimi realizohet gjithashtu përmes një pale të tretë e cila ndihmon palët të kuptojnë shkaqet e konfliktit dhe të përqendrohen në mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.
- Ndërmjetësimi është në thelb një formë lehtësimi. Ndërmjetësuesit lehtësojnë një proces negociatash. Kjo do të thotë që gjatë ndërmjetësimi realizohen disa negociime në të njëjtën kohë. Në këtë rast negociimi ndihmohet nga pala e tretë asnjënjë (neutrali) që është ndërmjetësi.

Këto metoda ligjore dhe jashtë gjyqësore përpiqen ti lënë një vend të gjerë zgjidhjes mbi baza vullnetare të konfliktit dhe të përqendrohen në disa aspekte të veçanta të konfliktit.

- Arbitrazhi si një alternativë detyruese vendimmarrjeje private (jo publike siç është procesi gjyqësor) tepër e përdorshme në një sërë rastesh por kryesisht në ato me natyrë tregtare. Si i tillë arbitrazhi ka ngjashmëri evidente edhe me mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve por edhe me procesin gjyqësor. Në këtë proces, vendimi për zgjidhjen e problemit merret nga pala e tretë asnjënjë (arbitri ose arbitrat) duke iu imponuar palëve pavarësisht pëlqimit të tyre, kuptohet pasi ato (palët) dëgjohej. Në këtë këndvështrim por edhe disa të tjera është një gjyq. Ndërkohë palët kanë mundësinë të zgjedhin vet arbitrin e tyre dhe të kenë përmes këtij procesi një sërë avantazhesh të karakterit privat, ekonomik dhe kursimit të kohës.

3. Pse ZAM në Shqipëri?

Ka disa arsye parimore të cilat duhet të nxisin sistemin e drejtësisë civile e më gjerë të promovojë e integrojë procedurat e ZAM. Së pari këtu vlen të përmendet roli i ridimensionuar i gjykatës në një shoqëri që ka tendencë drejt modernes por aq edhe komplekse e në rritje. Është koha për të ndryshuar disa metoda tradicionale dhe të përfitohet nga avantazhet e reja. Gjykata si “qendra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” nuk mund të jetë e vetmja “task force” e cila promovon zgjidhje të drejtë, të shpejtë dhe ekonomike të mosmarrëveshjeve. Kështu që ka një arsye pragmatike e cila fokusohet pikërisht në rolin që luan ZAM. Në këtë mënyrë është vet publiku por edhe inkurajimi i profesionistëve dhe institucioneve shtetërore që do të bëjë të mundur zhvillimin e ZAM si dhe adresimin e drejtë në përzgjedhjen e një opsioni që është më i përshtatshëm për

zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të caktuar. Së dyti, ndërsa gjykata është një institucion tepër i rëndësishëm në shoqëri si një arbitër i fundit për mosmarrëveshjen, tashmë komuniteti ka një varietet mjetesh për të lehtësuar zgjidhjet me kosto efektive (dihet që rruga gjyqësore ka kosto të larta ligjore dhe procedura të ngadalta), në kuptim të gjerë, për një kategori të gjerë mosmarrëveshjesh. Kjo siguron akses më të gjerë të publikut në drejtësi sepse vetë palët përfshihen në krijimin e zgjidhjes. Ky duhet të jetë interesi i shtetit të së drejtës. Por pavarësisht avantazheve të tilla si shpejtësia e procedimit, favorizimet ekonomike, eliminimi i formalizmit, konfidencialiteti, jo publiciteti, etj, instrumente të tilla (kryesisht arbitrazhi) kanë mbetur vetëm si zbukurime ligjore. Ndërkohë është me vend të themi se edhe aspektet ligjore të rregullimit të këtyre instituteve kanë vend për ndërhyrje e modifikime specifike në përshtatje me realitetin shqiptar dhe bashkëkohore.

Mendoj se sikurse aktorë të tjerë të rëndësishëm të tillë si gjyqtarët, prokurorët, noterët, avokatët etj, edhe ndërmjetësit dhe arbitrat, kanë mundësi të luajnë një rol eminent në stabilitetin social dhe në zgjidhjen e konflikteve. Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve duhet patjetër të marrë në konsideratë shumë faktorë, tërësia e të cilëve çuan në konflikt dhe e krijuan mosmarrëveshjen, të vendosë prioritete në raportet midis këtyre faktorëve dhe peshës së tyre në situatën konfliktuale të tashme dhe të perspektivës, të kuptojë shkallën e vlerës së secilit prej tyre, etj, etj. Jo në ë gjitha rastet gjykata e ka një komoditet të tillë. Kjo edhe për shkak të mbingarkesës. Prandaj, edhe shpesh herë sugjerohet që në mosmarrëveshjet e mundshme dhe të pranueshme për zgjidhje me ndërmjetësim ose arbitrazh përpara se të veprohet duhet një orientim i personave duke nënvizuar se ZAM është jo rrallë shumë më i përshtatshëm, për shkak të çështjeve delikate, të pleksura keq, emocionale dhe reale, pronësore dhe jo-pronësore, që lidhen me mosmarrëveshjen, se sa mekanizmat formal të zgjidhjes.

4. Faktorët kryesorë që ndikojnë në favor të ZAM në Shqipëri

Nëse duam të dimë situatën e ZAM në Shqipëri është e rëndësishme që të njohim bazën ligjore aktuale, realiteti e funksionimit të këtyre alternativave, arrijtjet nëse ka të tilla dhe të identifikohen problemet nëse ka të tilla që duhen zgjidhur dhe si duhen zgjidhur. ZAM nuk është një kështjellë e ngritur në hava. Edhe në Shqipëri, ZAM ka mbështetjen e burimeve të ndryshme tradicionale, ideologjike dhe tashmë edhe ligjore.

- **Mbështetja ligjore e ndërmjetësimit:**Ligji nr. 9090, datë 26.6.2003 “Për ndërmjetësimin”², rregullon çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje jashtë gjyqësisht për çështje për të cilat juridiksioni gjyqësor nuk është i detyrueshëm.
- Kodi i Procedurës Civile, n. 171, 361, (veprimet e pajtimit të gjyqtarit në seancën përgatitore dhe në gjykimet e posaçme që lidhen me martesën e familjen);
- Kodi Civil, nenet. 78, 203, 207, 262, 281-284, 486, 511, 625, 973-981, (përfaqësimi pa tagra, bashkëpronësia, pjesëtimi i sendit, shpërblimi i dëmit, kontrata e ndërmjetësimit);
- Kodi i Familjes, neni 66, (marrëveshja për regjimin pasur martesor), n. 125, (zgjidhja e martesës me marrëveshje), n. 134-136 (pajtimi për zgjidhjen e martesës), n.221 konfliktet për fëmijën;
- Ligji “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Marrëdhëniet me fëmijët”, Nr. 9359, dt. 24.3.2005, n 7/b, (marrëveshje miqësore dhe zgjidhje me pajtim);
- Kodi i Punës³, nenet 165, 189, (procedurat dhe afatet 30 ditore), 191-195, (zgjidhja e konflikteve nga marrëdhëniet e punës dhe kontratat kolektive, Zyra Kombëtare e punës dhe zyrat në rrethe, që kanë iniciativë të propozojnë marrëveshjen, n. 197, zyrat private të ndërmjetësimit të parashikuara në kontratën kolektive.
- Kodi i Procedurës Penale, nenet 59 dhe 284, ku përfshihen:
 - Neni 59, Kodi Procedurës Penale të R. Shqipërisë. “Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112/1,119, 120, 121, 122,125,127,148,149, dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të

² ky ligj i ri shfuqizoi ligjin nr.8465, datë 11.03.1999 “Për ndërmjetësimin për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve” duke zgjeruar, plotësuar, forcuar dhe korrigjuar atë.

³ Shih Ligjin nr.796, datë 12.0.1995 (ndryshuar) “Kodi i Punës së R.SH, në të cilin nënvizohet se zyrat e pajtimit janë krijuar dhe veprojnë për të zgjidhur mosmarrëveshjet në marrëdhëniet e punës. Procedura e pajtimit është falas dhe rregullohet me VKM. Kodi i Punës parashikon edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me anë të zyrave private të pajtimit ose arbitrimin privat të zgjedhura nga vet palët. Zbatimi i praktikë ende kërkon shumë impenjim.

paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

- Neni 284, Kodi Procedurës Penale të R. Shqipërisë. “Veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102/1, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal. Ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Ankimi bëhet tek prokurori ose në policinë gjyqësore.
- Kodi Penal: nenet 90-92, 112/1, 119-122, 125, 127, 148, 149, 254 (rrahja, plagosja e rëndë dhe lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, fyerja, shpifja, si dhe nenet 85, 89, 102/1, 105, 106, 130, 239-241, 243, 264, 275 dhe 318, (kur procedimi penal fillon nga prokuroria ose policia gjyqësore vetëm duke u bazuar në ankimin e viktimës, të dëmtuarit ndaj të akuzuarit si shkelja e rregullave të qarkull. Rrugor, plagosja e lehtë me dashje, etj

- **Mbështetja ligjore e arbitrazhit:**

Këtu një vend të veçantë zënë dispozitat e Kodit të Procedurë Civile. Ky Kod i ka rezervuar një kapitull të veçantë funksionimit të arbitrazhit si një instrument vullnetar për zgjidhjen e konflikteve pasurore. Sipas dispozitave të KPC, çdo pretendim pasuror apo kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, mund të jetë objekt i një gjykimi të arbitrazhit. Palët nuk janë të detyruara t’i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e konfliktit midis tyre. Ato mund të zgjidhin me marrëveshje midis tyre, “gjyqtarët-arbitra” si dhe rregullat procedurale të procesit të arbitrazhit. Marrëveshja për arbitrazh mund të arrihet njëkohësisht me lidhjen e marrëveshjes kryesore (bazë) apo dhe në momentin kur lind konflikti. Edhe në rast se konflikti është drejtuar për gjykim në juridiksionin gjyqësor, palët mund të arrijë marrëveshje gjatë gjykimit dhe ta transferojnë gjykimin e mosmarrëveshjes në arbitrazh.

Në marrëveshjen për arbitrazh duhet përcaktuar mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave dhe objekti i mosmarrëveshjes, në rast se kjo e fundit ka lindur, në të kundërt, marrëveshja është e pavlefshme. Persa i përket procedurës së arbitrazhit, palët kanë liri të plotë zgjedhjeje, me të vetmin kufizim, që të garantohet barazia ndërmjet palëve dhe kontradiktoriteti i debatit. Vendimet e arbitrazhit janë të formës së prerë, pasi nuk mund të ankimohen. Janë parashikuar veç disa raste, kur vendimi mund të apelohej në Gjykatën e Apelit, e cila mund të prishë apo ndryshojë vendimin e arbitrazhit. Në këto raste ajo vendos për themelin e mosmarrëveshjes, por pa kaluar

kufijtë e misionit të caktuar arbitrazhit, nga palët. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit nuk lejohet asnjë formë ankimi. Ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit kryhet në të njëjtën mënyrë si për vendimet e gjykatave të sistemit të drejtësisë.

Në bazën ligjore të arbitrazhit vlen të përmenden edhe një sërë konventash të ratifikuara nga vendi ynë. Si të tillë përmendim:

- Ligji nr.8687, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën Europiane të Arbitrazhit"
- Ligji nr.8688, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit"
- Ligji nr.8012, datë 18.10.1995 “Për ratifikimin e Konventës “Për pajtimin dhe arbitrazhin brenda OSBE-së”.

U bë një kohë e gjatë që është ende në proces miratimi i projekt ligjit “Për Arbitrazhin Tregtar në Republikën e Shqipërisë” i cili mund të japë një impuls në rritje përdorimit të arbitrazhit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve tregtare.

- **Nevojat për ZAM në kontekstin social si faktorë nxitës.** Kjo sepse shteti dhe institucionet shfaqin dobësi në zbatimin e ligjit, përflitet për korrupsion në organet e drejtësisë dhe njerëzit kanë humbur besimin, rreziku i vetëgjyqësisë, vështirësitë ekonomike, etj
- Veprimtaria e OJF-ve, qendrave, fondacioneve

Në vendin tonë janë krijuar dhe funksionojnë disa organizata ose fondacione të krijuara si persona juridikë sipas dispozitave të Kodit Civil të cilat përfshijnë në veprimtarinë e tyre atë të ndërmjetësimit të mosmarrëveshjeve dhe të arbitrazhit. I tillë është FZM me qendër në Tiranë por më shtrirje gjeografike në të gjithë vendin dhe Qendra MEDART e fokusuar në ndërmjetësimin dhe arbitrazhin tregtar. Nga veprimtaria e këtyre konstatohet se arbitrazhi i çështjeve tregtare është tepër i limituar. Llojet e subjekteve që mund të ushtrojnë këtë veprimtari janë si personat fizike (fitimprurës ose jofitimprurës) ashtu edhe personat juridik (fitimprurës ose jofitimprurës) të tilla si Zyre, Qendër , Fondacion.

- **Mbështetja institucionale dhe e biznesit**

Në promovimin e ZAM një rol të veçantë ka Ministria e Drejtësisë si edhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Noterisë, Fakultetet e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, gjyqtarët (sepse ndërmjetësimi mund të ndërmerret kur kërkohet ose çmohet nga gjykata, arbitrazhi, organi përkatës shtetëror sipas ligjit, ose kur ky është i detyrueshëm), etj. Në institucione të tilla juristët, gjyqtarët, avokatët, etj kanë një vend dhe rol të veçantë dhe si të tillë ata kanë një lidhje të veçantë afinitive me ligjin dhe karakterizohen nga njohje e ndjeshmëri e lartë sociale veç asaj juridike. Avokati, noteri, juristi ka kredibilitetin e palëve. Këta të fundit ndajnë me të shqetësime dhe konfidenca dhe si të tillë juristët në përgjithësi kanë avantazhin tu sugjerojnë dhe edukojnë palëve alternativa jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nga dy aktivitete rajonale të zhvilluara mbi baza gjykatash Apelesh përkatësisht në Vlorë dhe Durrës rezultoi se gjyqtarët kanë konstatuar se gjykata mbingarkohet me çështje të cilat mund të zgjidhen lehtësisht jashtëgjyqësisht. Kjo mbingarkesë vjen edhe si rezultat i mangësive në formimin e juristëve të pushtetit vendor dhe të institucioneve të tjera të cilët e shohin gjykatën si të vetmin vend për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Avokati, juristët etj e njohin mirë sistemin e drejtësisë me të mirat dhe jo të mirat e veta dhe si rrjedhojë do të ishte në përfitim të klientëve të tyre dhe të atyre vet inkurajimi i ZAM. Në të vërtetë ndodh që ka një lloj hezitimi dhe frike në humbjen e klientelës nga avokatët të cilët rendin pas një çështjeje të zvarritur për vite me radhë në vend që të nxisin këto alternative e të pasurohen me eksperiencë të reja. Ndërkohë vlen të përmendet që noterët kanë një vend nderi për shkak se kanë të gjitha mundësitë të parashikojnë ZAM si mënyra të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rastin e hartimit të kontratave përmes klauzolave të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit.

Nëse do të ndalesha tek Ligji Nr.9109, date 17.7.2003 “Për profesionin e Avokatit në RSh” në të parashikohet:

- Avokati jep ndihmë juridike nëpërmjet: a) këshillimit ligjor për çështje të ndryshme;.... f) veprimeve të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj.
- Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij.
- Avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhënat, që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur.

Sipas Direktivave të BE (3.7.1.) Avokati duhet në çdo kohë të përpiqet të arrijë zgjidhjen më të leverdishme për mosmarrëveshjen e klientit dhe duhet të këshillojë klientin në faza të përshtatshme në lidhje me dëshirën për të arritur një zgjidhje dhe/ose një referencë për zgjidhje alternative për mosmarrëveshjen.

Pa dyshim që ndër më të interesuarit në ZAM duhet të jenë përfaqësuesit e biznesit të cilët ende nuk kanë mundur të shohin qartë avantazhet e këtyre alternativave duke u bërë shpesh herë shkak i tronditjeve të forta deri në shkatërrimin e bizneseve të ndërtuara me mund të madh.

- **Tradita**

Në historinë e shoqërisë shqiptare këto modele konsensuale për zgjidhjen e konflikteve ndonëse nuk kane pasur këtë shkallë institucionalizimi aktual, nuk mund te quhen krejt te reja. Pra, politikat e konsensusit nuk janë një e tashme pa te shkuar apo një e tashme pa perspektiva teorike e praktike. Në të drejtën e zbatuar në vendin tonë, qoftë në atë zakonore, fetare apo pozitive, gjejmë modele e shembuj të shumtë tradicional të zbatimit të metodave pajtuese e ndërmjetësuese. Kështu mund të përmendim rolin e veçantë që kanë luajtur pleqtë dhe gjyqi i pleqve por edhe kuvendi (që gjykonte në raste të veçanta) të cilët përpara se të gjykonin çështjen e paraqitur bënëin të gjitha përpjekjet për pajtim. Këtë rol të këtyre institucioneve zakonore e ka huazuar herë pas here edhe e drejta shtetërore e deri në ditët tona⁴. Gjykatat e fshatit dhe të lagjes, të njohura edhe si gjykata shoqërore të krijuara qysh më 1968⁵, e madje të njohura si hallka përbërëse të sistemit gjyqësor, ndonëse, nisur nga masa e dënimit (qortim shoqëror ose gjobë deri në 1000 lekë) gjykonin “çështje të një rëndësie të vogël” (këtu duhet të kemi parasysh karakterin subjektiv të përcaktorit “të vogël”), me të marrë kërkesën duhet të bënëin të gjitha përpjekjet për pajtim të palëve në konflikt.

Të njëjtën mund të themi për arbitrazhin. Vendi ynë në këtë drejtim ka pasur një përvojë të pasur kryesisht për shkak të Arbitrazhit Shtetëror.

- Rezultatet e ZAM në vendin tonë dhe përvoja e suksesshme ndërkombëtare. këtu vlen të përmendet se ndonëse ka një përvojë të ofruar kryesisht nga OJF rezultatet pozitive ekzistojnë por nuk janë bërë dukshëm evidente. Ajo çka

⁴ shih p.sh ligjin nr.83, datë 23 Maj 1928 “Mbi administratën civile të mbretërisë shqiptare” në nenin 83-84 të të cilit nënvizohet se “Pleqësia paqton ngatërresat që lindin ndërmjet katundeve”; shih gjithashtu Ligjin “Për organizimin e pushtetit lokal”

⁵ ligji nr.4406, datë 24.06.1968 “Për organizimin gjyqësor” dhe ndryshuar

mendoj se duhet të bëhet më shumë evidente është ofrimi i statistikave reale lidhur me suksesin e metodës në rastet e veçanta.

- Obligimet për shkak të të qenit vend anëtar i Këshillit të Evropës të kësaj organizate që ka një kontribut të madh në promovimin e ZAM përmes një sërë rekomandimesh⁶; aspirata për të qenë vend anëtar i BE⁷ dhe detyrimet e përjasjes dhe të harmonizimit që burojnë nga MSA
- avantazhe të tjera që burojnë nga vet alternativat e përzgjedhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla si: shpejtësia e procesit, vullnetarizmi, konfidencialiteti, efektet e vendimit, etj

5. Çfarë mund të zgjidhet përmes ZAM?

A) Çfarë mund të ndërmjetësohet?

Gama e çështjeve që mund të ndërmjetësohet është e gjerë. Ndërmjetësimi, (neni 2\1) zbatohet për zgjidhjen e te gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare dhe ato penale. Në këto të fundit është fjala për çështjet që shqyrtohen nga gjykata, me kërkesën e te dëmtuarit akuzues ose ankimit të të dënuarit, sipas neneve 59 dhe 284 te Kodit te Procedurës Penale. Ndërmjetësimi i çështjeve familjare ka për qëllim të shmangët procedimi përpara autoriteteve gjyqësore, të cilat përgjithësisht ndikojnë mbi fëmijët⁸. Me anë të

⁶ Rekomandimi nr.(81)7 i komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës “mbi masat për të lehtësuar aksesin tek drejtësia” përfshin edhe një parim që quhet “parimi i thjeshtësisë” sipas të cilit kërkohet që të merren masa për të lehtësuar apo inkurajuar zgjidhje alternative jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve. Ky rekomandim që ka të njëjtën linjë me atë (86)12 lidhur me masat për të penguar apo pakësuar mbi ngarkesën e tepërt të gjykatave” adreson tek të gjithë profesionistët e lirë të fushës juridike detyrën për të sugjeruar apo inkurajuar palët që në rast mosmarrëveshjeve të mos rendin drejt e tek gjykata pa tentuar në avantazhe paragjyqësore të zgjidhjes. një rëndësi të veçantë kanë gjithashtu: Rekomandimi nr.(2002)10 mbi ndërmjetësimin në çështjet civile i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës; Rekomandimi nr. (98)1 mbi ndërmjetësimin në çështjet familjare i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës; Rekomandimi nr. (99)19 mbi ndërmjetësimin në çështjet penale i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës; Green paper mbi ADR në të drejtën civile dhe tregtare e Komisionit të Komunitetit Evropian; UNCITRAL Model Law on International Commercial Conciliation with guide to enactment and use (2002); Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council on certain aspects of mediation in civil and commercial matters (2004/0251).

⁷ Shih **Direktiva e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian “Mbi disa aspekte të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare” (2005); “green paper on ADR”.**

⁸ Neni 13 i Konventës Evropiane "Për të drejtat e fëmijëve".

ndërmjetësimi mund të zgjidhen mosmarrëveshje të tilla si ato midis bashkëshortëve dhe bashkëjetuesve dhe anëtarëve të tjerë të familjes; ato që burojnë nga detyrimi për ushqim; mosrealizimi i detyrimeve që burojnë nga përgjegjësia prindërore; konfliktet pasurore midis bashkëshortëve; kujdestaria pra, se ku dhe me kë do të qëndrojë fëmija; marrëdhëniet me fëmijën që duhet të ketë prindi me të cilin fëmija nuk jeton ose edhe anëtarë të tjerë të familjes si gjyshërit etj. Alternativa e ndërmjetësimi paraqet shumë interes edhe në konfliktet civile dhe është shtrirë në çështjet tregtare dhe ato penale të tilla si ndërmjetësimi midis viktimës dhe dhunuesit.

Në këtë mënyrë ligji i ri e parashikon ndërmjetësimin si një alternativë për zgjidhjen e konflikteve jo vetëm dhe thjesht të natyrës personale por edhe pasurore. Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ligji i ri rendit edhe fushën tregtare. Në këtë mënyrë këto çështje nuk janë vetëm ekskluzivitet i arbitrazhit si alternativë jashtëgjyqësore.

B) Por çfarë është ndërmjetësimi?

Nëse i referohemi nenit 1 të ligjit nr. 9090, datë 26.06.2003 “Ndërmjetësimi është **veprimtari jashtëgjyqësore** në të cilën palët kërkojnë ndërmjetësimin e **një personi të tretë** ose të një grupi personash, për të arritur në zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre dhe që **nuk vjen në kundërshtim me ligjin**”.

Pra, ndërmjetësimi është një proces në të cilin një palë e tretë e paanshme ndihmon palët e një mosmarrëveshjeje të negociojnë lidhur me marrjen e një vendimi të tyre të përbashkët. Ndërmjetësi **nuk ka pushtet detyrues**, nuk ka të drejtë të urdhërojë ose të detyrojë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes; ai nuk vepron as si gjyqtar, as si avokat ose arbitër për secilën nga palët. Ndërmjetësi nuk ka autoritetin për t'u imponuar palëve një zgjidhje dhe, për më tepër, edhe diskutimet janë të karakterit **konfidencial**. Kur një person zgjidhet si ndërmjetës nga palët në mosmarrëveshje, ai duhet të deklarojë të gjitha rrethanat që mund të shkaktojnë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

Ndërmjetësimi zbatohet në rastet **kur kërkohet dhe pranohet** nga palët, përpara ose pas lindjes së mosmarrëveshjes, kur çmohet nga gjykata, arbitrazhi ose organi kompetent shtetëror. Pra, ndërmjetësimi është **një proces vullnetar**. Nëse një palë i kërkon tjetrës ndjekjen e procedurave të ndërmjetësimi dhe kjo e dyta nuk i përgjigjet brenda 30 ditëve ftesës së bërë, kjo mund të vlerësohet si mospranim për ndërmjetësim. **Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme rruga gjyqësore, nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.**

Ligji nuk e ka bërë të qartë thelbin e shërbimit të ndërmjetësimit. pra, çfarë është shërbimi i ndërmjetësimit, shërbim publik, shërbim privat apo mik. Nëse është publik duhet ta ketë Ministria e Drejtësisë, nëse është privat institucioni duhet te vet-rregullohet (Ministria e Drejtësisë do të ketë askes ne rekrutim dhe disipline), nëse është mik duhet te jete një procedure e ngjashme me shërbimin e noterisë. A do të ketë një regjistër të ndërmjetësve? pa dyshim që regjistri ose do te mbahet nga Ministria ose kjo do te lajmërohet zyrtarisht për listën e ndërmjetësve.

Krijimi Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve ose Mediatorëve dhe statusi i saj është domosdoshmëri dhe rezulton se ligji aktual është i mangët në këtë drejtim.

C) Marrëveshja e arritur dhe efektet e saj. Cili është statusi i marrëveshjes së arritur me ndërmjetësim?

Marrëveshja e arritur gjatë ndërmjetësimit fiksohet në një dokument, i cili prodhohet në disa kopje dhe u jepet edhe palëve⁹. Nëse marrëveshja e arritur gjatë ndërmjetësimit është e vlefshme, kjo aktmarrëveshje e pajtimit **përbën një titull ekzekutiv** për palët dhe gjykatën. Por gjykata, nëse palët e kundërshtojnë aktmarrëveshjen, nuk është e detyruar të vendosë sipas saj. Aktmarrëveshja e ndërmjetësimit sjell këto efekte dhe detyrime për palët:

- Aktmarrëveshja duhet të bëhet me shkrim, kur objekti i saj lidhet me pagime shumash në të holla ose me dorëzime sendesh a kryerje shërbimesh. Kjo marrëveshje mund të kundërshtohet nga palët brenda 10 ditëve, në të kundërt **ajo shndërrohet në një titull ekzekutiv** në bazë të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe zyra e përmbartimit ngarkohet për ekzekutimin e saj.
- Nëse aktmarrëveshja kundërshtohet në gjykatë a prokurori, këto organe marrin parasysh zgjidhjen me ndërmjetësim, por nuk kanë pengesë ligjore të vendosin një zgjidhje të ndryshme nga ajo e palëve.

⁹Sipas nenit 14 të ligjit nr.9090, datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”: “Nëse palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre dhe së bashku me ndërmjetësuesit ose grupin e ndërmjetësuesve nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe zbatim të kushteve, rasteve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj, kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit.”

- Gjykata ose prokuroria mund ta konsiderojnë të pavlefshme marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur arrijnë në përfundimin se nuk pasqyron vullnetin e palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre ose kur zhdëmtimi është haptazi në shpërpjesëtim me dëmin e shkaktuar.

Në rastin kur mosmarrëveshja e ndërmjetësuar parashikon detyrime në të holla, dorëzimin e sendeve, kryerjen e shërbimeve të vlerësueshme e të dokumentuara me shkrim, **mund të kundërshtohet brenda 10 ditëve**, në të kundërt, **aktmarrëveshja përbën titull ekzekutiv** dhe ngarkohet zyra e përmbartimit me ekzekutimin e saj. Edhe në rastin e kundërshtimit, mund të provohet përsëri në zgjidhje me ndërmjetësim.

Në lidhje me këtë pyetje kam frike se jo. Kjo dispozitë e ligjit të ndërmjetësimit del jashtë parashikimeve të KPC dhe qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parashikimin e KPC të kredisë si titull ekzekutiv, ku ajo shprehet se kredia e bankës është kushtetuese të jete titull ekzekutiv për hir të rolit të pazëvendësueshëm të saj në ekonomi.

D) Ligji parashikon rastet në të cilat zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim është e pavlefshme.

Ndërmjetësimi nuk ka të bëjë me mohimin e të drejtës së qytetarëve për të pasur akses te ligji dhe drejtësia dhe as që zbeh pushtetet e autoriteteve administrative dhe gjyqësore për të mbrojtur interesat e të gjithë palëve në mosmarrëveshje. Secila nga palët mund të kërkojë fillimin ose vazhdimin e gjyqësimit të çështjes në gjykatë ose arbitrazh, kur çmon se në këtë mënyrë mbron të drejtat e veta. Fillimi i zbatimit të këtyre procedurave nuk shfuqizon marrëveshjen për ndërmjetësim ose mundësinë e zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes përkatëse.

6. Sfidat drejt së ardhmes

Suksesi i ZAM në Shqipëri kërkon:

- rritjen e ndërgjegjësimit publik me qëllim që këto të bëhen të pranueshme dhe të natyrshme në kontekstin social duke u fokusuar në ndërgjegjësimin e trajnimit e komuniteteve të tilla siç janë ato të biznesit, profesionistëve, institucioneve shtetërore, etj
- rishikim të legjisllacionit për ndërmjetësimin dhe arbitrazhin dhe të Kodit të Procedurës Civile, KPP, KF e të Kodit Civil. Parashikimi i rasteve të

ndërmjetësimin të detyrueshëm në mënyrë specifike të tillë si për çështjet familjare, disa çështje civile, etj; Sipas rekomandimeve të KE mbi ndërmjetësimin në fushën familjare dhe atë penale, sidomos në rastet e veprave penale të kryera nga të miturit, rekomandohet që vendet anëtare të pasqyrojnë në legjislacionin e tyre detyrueshmërinë e procedurës së ndërmjetësimin, në shmangie të procedurës gjyqësore për rastet e mësipërme, duke arritur një zgjidhje më të mirë për palët, kosto më të ulët shpenzimesh dhe impakt më pozitiv në jetën shoqërore. Edhe Kodi i Procedurës Penale mund të parashikojë rastet kur vepra penale me një minimum, apo maksimum të caktuar (kryesisht kundravajtjet) dhe sidomos në rastin e veprave penale të kryera nga të miturit, të shmanget sa më shumë të jetë e mundur gjykimi gjyqësor dhe t'u krijohet palëve mundësia e zgjidhjes së çështjes me anë të ndërmjetësimin, në rastet kur ato me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë bien dakord dhe kjo marrëveshje e palëve duhet të konsiderohet e vlefshme në rastet kur autoritetet kompetente sipas ligjit, do të vendosin kalimin e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim.

- Rol aktiv të Ministrisë së Drejtësisë, të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve dhe profesionistëve ligjorë në përgjithësi. është shumë e rëndësishme që këta profesionistë të stimulojnë dhe të paravlerësojnë nëse një çështje mund të ndërmjetësohet përpara se ti drejtohet gjykatës. Të konsiderohet gjykata vetëm në rastet kur kjo është rruga e vetme dhe e fundit për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, në të kundërt të aplikohen ZAM.
- Ndërmjetësuesit, kur ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimin si profesion, organizohen kolektivisht për vendosjen dhe respektimin e rregullave profesionale dhe etike, të detyrueshme për t'u zbatuar gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie. Statusi juridik i DHKM të jetë për analogji i ngjashëm me atë të profesioneve të tjera të lira, siç janë Avokatia dhe Noteria. Veç faktit që të rregullohet me akt nënligjor, ekziston edhe varianti që brenda ligjit aktual të vihet një nen ku të përcaktohet struktura, përbërja dhe kompetencat e DHKM.
- cilësia e ofruesve të shërbimit të ZAM është një gur themeli për suksesin. Për këtë ka rëndësi të veçantë përzgjedhja e tyre, trajnimi, monitorimi dhe vlerësimi në vazhdimësi i kontributit të tyre